



DEMOKRACIA, ZGJIDHJA E VETME PËR PAQË



DEMOKRACIA, UDHËHEQJE E PËRBASHKËT


TUANA (10), ELVINA (10), ERINA (10), MUHAMED (11), OLTION (11), ENES (10)



Lexues të dashur a jeni duke e kuptuar se çka i bie udhëheqje e përbashkët? Nëse jo, atëherë do ta kuptoni nga artikulli ynë

Demokracia është qeverisje e përbashkët. Në demokraci nuk mund të udhëheq vetëm një person i caktuar, vetëm ai/ajo që ka para, apo vetëm ata që kanë pozita udhëheqëse në vendet e punës. Por, mund të udhëheqin të gjithë qytetarët e një vendi.

Demokracia për herë të parë është paraqitur në vitin



Me hapa të ngadalshëm, por të sigurt ecim përpara

507 p.e.s. në Athinë, në kryeqytetin e sotëm të Greqisë. Ndërsa, ajo ka ardhur edhe në Kosovë në vitin 2008 më 17 shkurt. Në demokraci ka respekt, tolerancë, solidaritet dhe liri.

E kur jemi tek liria do të përmendim lirinë e shprehjes, lirinë e lëvizjes dhe lirinë e të zgjedhurit. Në demokraci, përveç që kemi të drejtë për të zgjedhur, ne kemi të drejtë edhe për të kandiduar vetë për të qenë

të zgjedhur nga të tjerët. Normalisht se për këtë duhet t'i përmbushim disa kriteret. Niveli i demokracisë është rritur ndër vite. Këtë e dëshmon edhe pjesëmarrja edhe më e madhe e qytetarëve në vendimmarrje. Po ashtu, kjo dëshmohet edhe nga shtetet e shumta që praktikojnë këtë sistem të qeverisjes.

Në demokraci pranohet llojllojshmëria apo më mirë të themi diversiteti. Në këtë sistem nuk tentohet që të gjitha mendimet e qytetarëve të bëhen të njëjta, por besohet në respektimin e mendimeve të gjithsecilit.

Jemi shumë të kënaqur që sot patëm mundësinë që të mësojmë për demokracinë. Këto informata që i kemi marrë do t'i ndajmë edhe me të tjerët.


Vlera e demokracisë është shumë e madhe, andaj një gazetë nuk mjafton të flasim dhe të shkruajmë për të. Por, kjo është çka mund të bëjmë për momentin. Të lirë dhe të barabartë do të vazhdojmë të kontribuojmë për shtetin tonë demokratik.



Demokratët e vegjël, të lumtur dhe të gëzuar

VOTA ËSHTË E DREJTA JONË

NADIDE (11), SARA (10), FJOLLA (11), ERBLINA (10), VENIS (11), DIJON (11), MUSTAFË (11), ONUR (11),
KORAB (11)



Më poshtë në artikullin tonë, mund të gjeni më shumë informata rreth zgjedhjeve

Kur dolëm në klasën e V-të mësuesja na tha të zgjedhim një lëndë të cilën e pëlqejmë më shumë. Kjo është një zgjedhje të cilën e kemi bërë në përditshmërinë tonë. Ne gjithashtu e kemi zgjedhur kryesinë e klasës me vota dhe në mënyrë demokratike.

Edhe këtu në „Demos-ti“ votuam për sportin tonë të preferuar.

pjekur kur votojmë. Vota, po ashtu, nuk duhet të imponohet nga askush.

Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet parlamentare ku i zgjedhim deputetët si përfaqësuesit tanë shtetëror. Si dhe zgjedhjet komunale, ku i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse. Me rregull, zgjedhjet duhet të ndodhin çdo 4 vjet.

Ne kërkojmë nga ju që të merrni pjesë në procesin zgjedhor. Vota jonë është e drejta jonë dhe fjala jonë.




Siç po e shihni, edhe ne si fëmijë kemi të drejtë të zgjedhim atë që dëshirojmë në përditshmërinë tonë. Gjithsesi, për të marrë pjesë në procesin zgjedhor ne duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare. Ne mendojmë se kjo është mëse e drejtë. A e dini pse? Kur ne zgjedhim lëndën tonë të preferuar, apo sportin që na pëlqen, kjo zgjedhje jona nuk ndikon në jetën e askujt. Mirëpo, kur vendosim t'ia besojmë votën tonë dikujt, ai person do të luajë rol të rëndësishëm në jetën e të gjithë qytetarëve të vendit. Prandaj, duhet të jemi të



Autorët punëtorë të artikullit

KUVENDI DHE LIGJET E KOSOVËS SOT

RILIND (10), ARD (10), ARDIN (10), DARIS (10), LORIK (11), ENISA (10), ARIANA (11), RITA (10),
RIGA (10)



Ne sot patëm nderin të shkruajmë dhe të hulumtojmë për Kuvendin e Kosovës, sepse ne sot jemi gazetarë

Ashtu siç lexuat nga nëntitulli, sot do të flasim për Kuvendin. Ne mësuam fillimisht për funksionet e Kuvendit. Kuvendi ka funksione të ndryshme. Ato janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe ai kontrollues.

FUNKSIONI PËRFAQËSUES

Ky funksion do të thotë se deputetët e zgjedhur nga populli përfaqësojnë interesat e popullit.

FUNKSIONI LEGJISLATIV

Funksioni legjislativ do të thotë se Kuvendi ka për detyrë të bëjë miratimin apo mosmiratimin e ligjeve.

FUNKSIONI KONTROLLUES

Funksioni kontrollues ka të bëjë me detyrën e Kuvendit për të kontrolluar punën e Qeverisë.

Ne mësuam gjithashtu se në shtetin tonë kemi përafërsisht 2 milionë banorë. Këta qytetarë zgjedhin 120 deputetë, të cilët i përfaqësojnë ata në Kuvend. Nga këta deputetë 100 janë shqiptarë, 10 janë serbë dhe 10 të tjerë iu përkasin komuniteteve si: serb, goran, turk, egjiptian, boshnjak, romë dhe ashkali. Prej këtyre deputetëve ka edhe gra dhe burra. Kuvendi i Kosovës gjendet me lokacion në Prishtinë, në kryeqytetin tonë. Për të funksionuar ky institucion sa më mirë, në Kuve-

nd punojnë edhe kryetari dhe nënkryetarët. Këta persona e përbëjnë kryesinë e Kuvendit.

LIGJET

Ligjet janë rregulla të cilat merren me rregullimin e shtetit dhe të jetës së qytetarëve. Prandaj, ato duhet të zbatohen nga populli. Ligjet e Kosovës gjithmonë miratohen në Kuvend. Prej aty, shkojnë në Qeveri dhe nga Qeveria vijnë tek ne. Ligjet janë të ndryshme dhe janë për çdo lëmi të jetës sonë. Ne kemi ligje edhe për sigurinë në komunikacionin rrugor.

Nëse ne do të ishim deputetë do ta propozonim ndalimin e veturave të cilat nuk i përkasin kryeqytetin të Prishtinës të hyjnë në kryeqytet, për shkak të ndotjes së madhe të ajrit që po ndodh ditëve të fundit. Po ashtu, do të propozonim ligje të cilat nëse do të miratoheshin do të mbronin jetët e kafshëve, e sidomos të atyre në zhdukje. Faleminderit për vëmendjen tuaj.



Gazetarët më të mirë të demokracisë

MEDIA DHE DEMOKRACIA


HARIS (10), TAULANT (10), VENIS (10)

Si do të ishte jeta jonë pa media ? Ku do të mund t'i merrnim informacionet më të reja nga rajoni dhe bota? Këtë na e mundëson...


Media, e cila është e njohur si pushteti i katërt pas Kuvendit, Qeverisë dhe Gjykatës. Media është e njohur si burimi më i mirë i informacionit. Përmes saj, qytetarët mund të informohen për ngjarjet më të reja në vend dhe në botë. E nëse flasim për lidhshmërinë e medias me demokracinë, atëherë do të mund të vërejmë se të dyja e kanë të vështirë të funksionojnë pa njëra-tjetrën. Shembull të kësaj e kemi mbajtur e procesit zgjedhor, ku përmes medias e dijmë se cili/a është kandidati/ja më e mirë për t'u votuar. Pastaj, e kuptojmë se kush ka fituar më së shumti vota dhe është zgjedhur përfaqësues/e e shtetit. Kemi dy lloje të medias: media e shkruar dhe ajo elektronike. Nga vizatimet tona do të mund ta vëreni se kush hyn tek media elektronike dhe kush hyn tek media e shkruara.



Tuana duke dhënë intervistë për media



Televizionet bëjnë pjesë tek media elektronike



Gazetat, revistat, libri bëjnë pjesë tek mediat e shkruara



Përmes medias e dijmë se kush është kandidati i duhur për t'u zgjedhur përfaqësues i vendit



Media është çelësi kryesor i demokracisë. Përmes saj promovohet shprehja e lirë e secilit person



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Naim Frashëri“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri